



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA FIER

Nr. 4534 Prot.

Fier, më 14.04.2025

Projekt - Vendim

Nr. 36 dt. 14.04.2025

“Për miratimin e listës së përdoruesve faktikë të tokës bujqësore në Zk. 3358, fshati Sheq Marinas Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier”

Këshillit të Bashkisë Fier sot më datë ____ .04.2025, i paraqitet për shqyrtim materiali i përgatitur nga Drejtoria e Menaxhimit të Pronave, mbi bazën e kërkesës së paraqitur nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës Drejtoria Vendore Fier për miratimin e listës së përdoruesve faktikë të tokës bujqësore në zk. 3358, fshati Sheq Marinas Njësia Administrative Topojë Bashkia Fier, bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 14 pika 3 e ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, nenit 68 të ligjit 111/2018 “Për kadastrën” dhe VKM 1182 dt. 24.12.2020 kreu 2 pika 10 “Për miratimin e rregullave të lëshimit të akteve të kalimit në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, shkresën nr. 2711/2 prot. dt. 09.04.2025 të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore Fier, **Kryetari i Bashkisë;**

Propozon:

-Të miratojë listën e përdoruesve faktikë të tokës bujqësore në Zk. 3358, fshati Sheq Marinas Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier”, bashkëlidhur lista sipas shkresën nr. 2711/2 prot. dt. 09.04.2025 të A.Sh.K. Drejtoria Vendore Fier.

-Ngarkohet ekzekutivi për vijimin e mëtejshëm të procedurave administrativo – ligjore pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Drejtoria Vendore Fier.

Drejtoria e Menaxhimit të Pronave

Drejtori: A. Behari

Drejtoria Juridike

Drejtoreshë: E. Kapllanaj

**NË MUNGESË DHE MË URDHËR
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Martin DODI**



**KRYETARI
Armando SUBASHI**